



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 28.02.2019, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Migjen Shala (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Sokol Berisha (AAK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Fiknete Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), Bukurie Canolli (LB) dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Visare Gashi (PSD), dhe Uran Ismaili (PDK).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimin për rendin e ditës, **Bashkim Beha**, kërkoi nga të pranishmit që të mbahet një minutë heshtje me rastin e vdekjes së albanologut, akademik Idriz Ajeti.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Eman Rrahmani tha se në mbledhjen e KPF-së, me shumicë të votash, kemi kërkuar që të largohen nga rendi i ditës pika e 10-të dhe e 11-të, d.m.th. "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm, zona "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B", pjesa jugore" si dhe "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit", mirëpo këto propozime nuk qenkan marrë parasysh dhe kanë ardhur prapë në seancë këto pika.

Arsyeja pse kemi vendosur që këto pika të mos sillen për diskutim dhe votim në Kuvend, është për shkak se e pengojnë procesin e hartimit të Hartës zonale dhe Planit zhvillimor. Ne mendojmë se këto dy pika dhe secili plan i hollësishëm rregullues, duhet të mos vijnë në Kuvend, derisa të mos përfundojnë Harta zonale dhe Plani zhvillimor, që janë dy dokumente shumë të rëndësishme për qytetin e Prishtinës.

Andaj, prapë e përsërisim kërkesën tonë që këto dy pika të hiqen nga rendi i ditës.

Fiknete Bejta bëri të ditur se, me kërkesë të familjarëve të familjeve të viktimave të luftës të lagjeve "Sofalia", ish-"Bledi" dhe "Toukbahçe", kërkoj që të futet në rend të ditës një pikë për miratimin e vendosjes së një obelisku, apo lapidari, në shenjë kujtimi për këto viktime. Janë gjithsej 15 familje që kanë familjarë të vvarë gjatë periudhës mars-qershor të vitit 1999, dhe kanë kërkuar përafërsisht diku një sipërfaqe prej 1.5 metër katror, te kryqëzimi i rrugëve "Dr. Lec Gradica" dhe "Shpëtim Robaj" në parkun "Toukbahçe".

Sami Boroci, sa u përket këtyre pikave që u propozuan të hiqen nga rendi i ditës, ne jemi që këto pika të qëndrojnë në rendin e ditës, të trajtohen dhe të miratohen, sepse nëse veç Harta zonale ka mundësi me i integruar këto plane në momentin e finalizimit të saj, atëherë unë nuk po e kuptoj se pse ne duhet me e stopuar këtë proces. Këto janë pika me interes goxha të veçantë për lagje të caktuara, kemi të bëjmë me kolektorin në lagjen "Kalabria", kemi të bëjmë me ndërtimin e një shkolle tek rasti tjetër, kështu që unë nuk shoh arsye se pse këto pika duhet stopuar.

Sa i përket pikës për Planin e mobilitetit, ky dokument duhet trajtuar në një seancë të radhës, në mënyrë që me pasur kohë të gjitha rekomandimet, vërejtjet tona me i paraqitur për këtë dokument, në mënyrë që të dalë një dokument sa më i mirë.

Halim Halimi tha se edhe ne si GP e kemi diskutuar çështjen e pikës së 10-të dhe të 11-të në mbledhjen e KPF-së. Kemi shprehur mendimin që të mos futen në rendin e ditës për Kuvend, mirëpo është çështja e këshilltarëve, me shumicë të votave mund ta përfshijnë në rendin e ditës për Kuvend dhe ta diskutojmë. Por, unë mendoj se e njëjta gjë na përsëritet, d.m.th. këto pika të planeve rregulluese të hollësishme sillen në Kuvend në mënyrë pothuajse të dhunshme, kështu që ne themi të hiqet prej rendit të ditës, me arsye se duhet të bëhet Harta zonale, që është dokument bazë për hartimin e planeve rregulluese të hollësishme. Tash e pesë vjet e njëjta gjë përsëritet, sillen këtu nganjëherë për mos me e bllokuar punën. Ka ndodhur që me shumicë votash është votuar, është marrë një vendim për fillimin e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme, por na e ka kthyer Ministria si të kundërligjshme. Të mësohemi njëherë e përgjithmonë të punojmë në bazë të ligjit, e jo tash kujt si t'i teket me punuar.

Egzon Azemi shprehu mendimin se nëse vazhdohet në këtë mënyrë me praktikën e miratimit të planeve të hollësishme, atëherë nuk e di çfarë kuptimi do të kishte që këto plane rregulluese të inkorporohen në Planin zhvillimor komunal dhe në Hartën zonale. Pra, nëse

zgjdhje qenkan planet rregulluese, atëherë Harta zonale dhe Plani zhvillimor komunal qenkan të panevojshme. Atëherë, duhet ta dimë dhe ta kemi të qartë të gjithë se a do të vazhdojë Komuna ta përfundojë Hartën zonale, për të cilën ka premtuar. Disa herë e kemi potencuar se sa zgjatë një Plan rregullues i hollësishëm, pra prapë se prapë zgjatë më shumë sesa afati për përfundimin e Hartës zonale. Kishte me qenë mirë që pika e 12-të dhe e 13-të, në fakt pika e 13-të të vendoset si pika e tretë ose e dytë e rendit të ditës, për shkak se nuk mund të flitet për plane të hollësishme rregulluese pa pasur informacione, të paktën bazike, se në cilin proces është Harta zonale dhe Plani zhvillimor.

Agim Gashi sugjeroi që për mbledhjen e radhës të përgatitet një pikë, që ka të bëjë me gjendjen e ndërtesave në lagjen "Ulpiana", afër fontanës. Në aspektin e sigurisë, ajo është gjendje emergjente, sepse komplet pjesa e izolimit të objekteve që janë 14-16 kate, është horrorizuar, ta quaj në kuptimin figurativ dhe të mirëfilltë. Nuk e di se çka duhet të ndodhë tjetër në ato objekte, që të reagojnë organet përkatëse që merren me sigurinë e qytetarëve në komunën e Prishtinës. Qysh në vitin 2013, ka qenë i planifikuar buxheti për ndërhyrje në ato ndërtesa, por nuk e di se pse nuk është marrë parasysh ajo shkallë e rrezikshmërisë në ato objekte, në mënyrë që të gjendet një formulë për sanimin e gjendjes.

Leutrim Retkoceri shprehu mendimin se pikat e rendit të ditës që janë paraparë për sot janë të pakta, ka edhe shumë pika që do të duhej të shtoheshin, për shkak se një seancë në muaj nuk është e mjaftueshme për t'i trajtuar të gjitha problemet që janë në komunën e Prishtinës. Në mesin e shumë e shumë problemeve, bën pjesë edhe një problem që i mundon qytetarët e Prishtinës, e që është mungesa e parkingjeve në komunën e Prishtinës. Kjo duhet të diskutohet dhe të futet si pikë e rendit të ditës, për shkak se qytetarët për çdo ditë po ballafaqohen me problemin e mungesës së parkingjeve.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin, që pikat "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa jugore", dhe "Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit", të hiqen nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për, 25 vota kundër dhe 1 abstenim, këto pika mbesin si pika të rendit të ditës për diskutim.

Lidhur me propozimin e dhënë nga Fitnete Bejta, arsyetimin e dha **Muhedin Nushi**, nënkryetar i Komunës. Ai tha se për këtë propozim, bashkë me grupin punues, jemi pajtuar që të presim edhe pak kohë, me arsyetimin që të dalim me një propozim konkret.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin që pika e 13-të e rendit të ditës (ashtu si është propozuar në rend dite), të dalë si pikë e 10-të e rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, 15 vota kundër dhe 2 abstenime, pika e 13-të "Informatë për hartimin e Hartës zonale të komunë së Prishtinës dhe Planit zhvillimor komunal të Prishtinës", del për diskutim si pikë e 10-të e rendit të ditës.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin, që në rend dite të përfshihet pika "Diskutimi për mungesën e parkingjeve në komunën e Prishtinës".

Kryesuesi konstatoi se më 18 vota për, 19 kundër dhe 2 abstenime, nuk u miratua propozimi që kjo pikë të përfshihet për diskutim në rendin e ditës.

Lidhur me propozimin e dhënë nga z. Retkoceri, kryesuesi tha se kur do të diskutohet për Planin e mobilitetit, do të diskutohet edhe për çështjen e mungesës së parkingjeve në komunën e Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për, 1 kundër dhe 3 abstenime, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2018 (TM4);
3. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2018;
4. Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2019;
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK " Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Policisë së Kosovës;
7. Propozimrregullore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
8. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës 2019-2021;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri (Rifat) Hoxhës dhe Besnik (Halit) Asllanit;
10. Informatë për hartimin e Hartës zonale të komunës së Prishtinës dhe Planit zhvillimor komunal të Prishtinës;
11. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Matit 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa jugore;
12. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit;
13. Informatë për procesin e Planit të mobilitetit;
14. Pyetje dhe përgjigje;
15. Të ndryshme.

Para se të fillonin diskutimet lidhur me pikat e rendit të ditës, **Osman Bilaca**, përfaqësues nga ekzekutivi, i njoftoi të pranishmit rreth emërimit të drejtorëve të rinj në Komunën e Prishtinës, si në vijim:

Adonis Tahiri, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit;

Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit;

Valbona Osmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit;
Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe
Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 39 vota për dhe 2 abstenime, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë dhe e tretë.

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2018 (TM4) dhe Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar--31 dhjetor 2018.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, tha se bazuar në Ligjin për financa, kemi përgatit Raportin (TM4) dhe Raportin vjetor të Komunës së Prishtinës.

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën janar-dhjetor 2018, është përgatitur nga Drejtoria e Financave, duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, nr. O3/L-048, përkatësisht neni 46. Në këtë raport jemi përpjekur që në mënyrë të hollësishme të bëhet raportimi i të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve që janë bërë në Komunën e Prishtinës. Sipas këtij raporti, realizimi i të hyrave vetjake në Komunën e Prishtinës ka arritur një rritje diku në mbi 97% realizimin e tyre, ndërsa sa i përket shpenzimeve që janë bërë gjatë këtij viti, duke përfshirë këtu edhe bartjen e mjeteve nga viti 2017, shpenzimet janë bërë në 5 kategori kryesore: "Paga dhe mëditje", "Mallra dhe shërbime", "Komunali", "Subvencione" dhe "Kapitale". Pra në këtë raport kemi bërë paraqitjen në mënyrë të hollësishme për secilën kategori nga janari deri në dhjetor, 2018.

Halim Halimi tha se nëse e shikojmë si raport, është i strukturuar dhe i sistemuar mirë, ashtu si e parasheh ligji, mirëpo nëse hyjmë në përmbajtje në brendinë e tij, shohim se nuk është mirë, sepse Komuna e Prishtinës nuk ka qenë kurrë më keq me shpenzimin e buxhetit.

Nga buxheti prej 86 milionë euro, janë harxhuar 61 milionë dhe kanë mbetur mjete të pashpenzuara 25 milionë. Edhe ato mjete të cilat janë shpenzuar, kryesisht janë nga shpenzimet për komunali, subvencione, mallra dhe shërbime.

Këto mbetje të cilat kanë mbetur pa u shpenzuar, japin sinjal të kuptojmë se është bërë edhe një keqplanifikim, se është planifikuar një buxhet më i madh, ndërsa shpenzimet nuk janë bërë. Krahas keqplanifikimit, shohim edhe keqmenaxhim, se po të menaxhoheshin me kohë për investime kapitale të shpallëshin tenderët që të kryheshin punët, sot nuk do ta kishim gjendjen qysh e kemi tash me 25 milionë mbetje.

Sa i përket të hyrave, në raport shihet dukshëm, duket që janë mirë, d.m.th. janë 96%, mirëpo nëse ndalemi e analizojmë, nuk është mirë, ngase kemi planifikuar më shumë të hyra për Komunën e Prishtinës, por nuk kemi mundur t'i realizojmë.

Duhet angazhuar për identifikimin e faktorëve të cilët kanë ndikuar deri te mos shpenzimi, mos realizimi i tillë i buxhetit komunal dhe të merren masa, ta dinë ku është fajësia, a është subjektive, d.m.th. te drejtorët, apo te planifikimi. Prandaj, është detyrë parësore e kryetarit të Komunës ta hartojë një strategji për dalje nga ky kolaps.

Mirsad Vitia tha se sipas këtij raporti tremujor, nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, shihet qartë se ka përmirësime tek performancat e të hyrave tatimore dhe jo tatimore me një rritje të kënaqshme, për çka duhet vlerësuar puna e secilit në këtë drejtim. Duhet të theksohet se kjo rritje vjen kryesisht dhe më së shumti nga pagesat e mbeturinave, të cilat i arkëton Komuna për herë të parë gjatë vitit 2018. Shpeshherë shuma e paraqitur në kolonën e zotimeve ose obligimeve, tejkalon shumicën e realizimeve të tremujorëve të vitit. Sa i përket shpenzimeve kapitale, kemi një rënie drastike në krahasim me vitin 2017. Lidhur me Drejtorinë e Kulturës, tha se sa ishte z. Yll Rugova, i kam parashtruar pyetje rreth furnizimit me kompjuterë për institucionet kulturore, dhe përgjigja e zotit Rugova ishte se këtu i patëm bashkuar të gjithë tenderët e kompjuterëve me një vend dhe nuk po figuron blerja e tyre. Bazuar në këtë, shtroj pyetjen: Pse nuk figuron blerja e kompjuterëve? A e ka fituar dikush këtë tender? Pse asnjëherë nuk janë sjellë këta kompjuterë?

Sa i përket shpenzimeve kapitale, gjatë kësaj periudhe vetëm dy drejtori, ajo e Arsimit, me 29.48%, ka pasur një progres gjatë (TM4), dhe Drejtoria e Bujqësisë, një progres prej 45.36%, kryesisht me ndarje të subvencioneve.

Fiknete Bejta u shpreh se ky raport krahasuar me raportin paraprak të vitit 2018, është më i plotë dhe ka informacione të bollshme financiare edhe sa i përket rezultateve. Vërehet një rritje tek të hyrat vetjake të Komunës për 38.37% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Shpenzimet buxhetore janë rritur për 1.70%, gjithashtu kemi një rritje në subvencione dhe transfere për 30.11% më shumë se në vitin 2017. Por, një normë jo e kënaqshme e shpenzimeve është dhe vërehet tek shpenzimet kapitale, ku ka një zvogëlim për 35.39% në krahasim me vitin 2017, ose në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në raport vërehet se defekti i menaxhimit të Komunës është te shpenzimet kapitale, e që nuk është fajtor vetëm menaxhimi i Komunës, por edhe procedurat e tenderimit, sepse e njëjta burokraci e shpenzimeve të procedurave tenderuese e pamundëson zhvillimin normal të këtyre projekteve në Komunë. Realizimi i të hyrave është i kënaqshëm për disa të hyra tatimore e jotatimore, do të thotë këto kanë arritur sipas projeksioneve financiare. E dyta, kemi rritje të shpenzimeve financiare për 1.70%, por kemi një ngecje tek shpenzimet kapitale. Andaj, Komuna duhet të ndërtojë një strategji të re, edhe pse ka probleme të procedurave tenderuese, jo me fajin e Komunës, por me procedurat që i ndërton Ligji për menaxhimin e financave publike.

Blerand Stavileci theksoi se ky raport ka të dhëna të mjaftueshme, po mendoj se është çështje shumë serioze dhe ndoshta meriton edhe një trajtim edhe më shumë se kaq, ndoshta për ta shkoqitur nga këtu dhe pastaj për ta diskutuar në ndonjërin prej seancave të radhës, duke kërkuar nga Zyra ligjore të na japë më shumë detaje. Në këtë raport figurojnë lëndët, si: Raporti i detyrimeve kontingjente nga Zyra e përfaqësimit juridik, ku janë 77 lëndë të vitit të kaluar, që kanë të bëjnë me kompensim të dëmeve mbi borxh, ndërsa të tjerat janë lëndë pronësore, administrative, penale etj. etj., që nuk kanë të bëjnë me mjete financiare. Andaj, kërkoj që për këtë çështje ta mendojmë se si ta trajtojmë si të veçantë në ndonjërin prej seancave, apo nëse jo, në seancë ta shohim një mënyrë tjetër, por të informohemi më shumë

dhe ta dimë se si janë punët dhe çka ka mundësi të bëhet. Pra, kjo është e dëmshme për buxhetin e Komunës dhe qytetarët e saj.

Arbenita Murseli, sa i përket këtij raporti financiar për tremujorin e fundit të vitit 2018, tha se është një raport financiar shumë më i kompletuar se ata paraprakë. Do të fokusohem te disa raporte dhe disa projekte të Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Pse nuk është shpenzuar buxheti që ka qenë i destinuar për këto projekte, si p.sh. “Ndërtimi i vendkalimeve për këmbësorë, kabinave të autobusëve dhe rregullimi”, janë gjithsej 18.000 euro, por nuk janë shpenzuar në asnjë tremujor të vitit 2018.

Po ashtu, “Trajtimi i kafshëve endacake”, gjithsej kanë qenë në dispozicion 100.000 euro, edhe pse një pjesë bukur e madhe e këtij buxheti janë shpenzuar në tremujorin e fundit të vitit 2018. Për vendosjen e kamerave të sigurisë në qytet nuk është shpenzuar asnjë euro, edhe pse janë të destinuara rreth 50.000 euro, cila është arsyeja? Gjithashtu, është edhe një projekt tjetër i Drejtorisë së Investime Kapitale, “Rruga mbi lumin Mat”, paratë për të cilin projekt janë siguruar qysh nga viti 2017, e që nuk ka filluar ende.

Agim Gashi tha se në aspektin teknik raporti ka lëshime të paqëllimta, se vlera e buxhetit për vitin 2018 nuk përputhet me pasqyrën tjetër, dhe dallimi në mes të këtyre dy vlerave është 246.722 euro, pra buxheti për vitin 2018 është 86.240.874,90 euro, ndërsa në pasqyrën tjetër financiare buxheti është 86.387.596,17 euro, pra duhet të figurojë sqarimi i plotë rreth një vlere buxhetore, kështu që kjo duhet të përmirësohet.

Çështja tjetër është, se në këtë raport do të mund të inkorporoheshin edhe çështje të tjera që indirekt lidhen me këtë që ka sjellë raporti financiar buxhetor. Ka shumë sektorë në Komunë, nga të cilët varen këto politika, siç janë: Zyra e prokurimit, Auditori i brendshëm, mund të ketë edhe ndonjë shërbim tjetër shumë i rëndësishëm, nga puna e të cilit varet kjo dhe në këtë raport nuk është cekur asnjë fjali. Po ashtu, në këtë raport do të duhej përmendur gjendja në ndërmarrjet komunale, pasi që ato ndërmarrje janë prona të Komunës së Prishtinës.

Shefqet Osmani theksoi se të gjeturat e raportit financiar, d.m.th. bazuar në raportin financiar të Komunës së Prishtinës për periudhën raportuese, gjëja më skandaloze është mosshpenzimi i buxhetit në masën e duhur dhe bartja e më se 25.000.000 eurove për vitin 2019. Pra, buxheti i Komunës për vitin 2018 ishte 86.397.781 euro, në këtë vlerë ishte edhe bartja e më se 14.000.000 euro mjete të bartura nga viti 2017. Në periudhën raportuese, Komuna e Prishtinës ka shpenzuar gjithsej 61.331.000 euro, pra mbetja e buxhetit për 2019 është 25.000.000 euro. Dështimet e kryetarit dhe qeverisjes së tij po vërehen edhe në pasqyrat raportuese financiare, e që sipas tyre shihet se të hyrat vetjake për vitin 2018 ishin rreth 28.616.000 euro, dhe kjo rritje në krahasim me vitin 2017, u krijua enkas nga gjobat në trafik dhe nga mbeturinat. Pra, të hyrat vetjake në vitin 2018 nuk kishin rritje. Performanca e të hyrave vetjake nuk është e kënaqshme, pasi që planifikimi është në disproporcion me realizimin. Te tatimi në pronën e paluajtshme ende nuk merret për bazë ngarkesa vjetore, pastaj arkëtimi i ultë i të hyrave edhe te qiraja e tokës, pra për këtë është dashur që drejtoria përkatëse të japë ndonjë sqarim për pronën komunale, e cila shfrytëzohet dhe nuk paguhet obligimet. Pastaj taksa nga realizimi i të hyrave për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike është skandaloze, etj. Ky raport është shumë i dobët. Këtë heshtas e ka pranuar edhe vetë kryetari, me ndryshimet që i ka bërë tash në dikasteret e veta, por mendoj se do të duhej që edhe kryetari me këtë rast me dhënë dorëheqje, për shkak se nuk është i aftë për menaxhimin e parasë publike.

Shefki Gashi u shpreh se duke pasur parasysh vërejtjet dhe shqetësimet e paraqitura për këtë raport, shihet se është një gjendje, ku nuk dihet kush është që mund ta zgjidhë këtë një të paaftësisë së menaxhimit të Komunës së Prishtinës nga kryetari aktual. Nga mos realizimi i projekteve të parapara në infrastrukturë dhe në shërbime të tjera, më së shumti janë të dëmtuar qytetarët. Kjo është një përgjegjësi edhe e kryesuesit të Kuvendit dhe e të gjithëve që jemi këtu, që ta sjellim kryetarin këtu para nesh, para qytetarëve, ta shohin ata se ai nuk është zgjedhur që të shkojë e t'i bëjë vërejtje BE-së, se nuk është kurrfarë faktori, por e ka për detyrë t'i kryejë punët e Komunës. Unë kurrë nuk kam punuar më punë koti në Kuvendin e Komunës së Prishtinës sesa këto 5 vite.

Çka do të bëhet tani me mjetet e parapara për projektet kapitale, si do të menaxhohen ato, si do të harxhohen ato mjete që janë të destinuara për interesin e qytetarëve?!

Eman Rrahmani tha se në mbledhjen e KPF-së kam pasur një vërejtje lidhur me Tregun e qytetit, ku te "Shpenzimet kapitale" është i paraqitur një shpenzim, që në fakt nuk ekziston ai shpenzim te Tregu i qytetit, dhe mendoj që ka të pavërteta në raport, që mund të ketë vend edhe për hetim nga Prokuroria. Kam kërkuar që të sillen të gjitha transaksionet që janë bërë nga Komuna e Prishtinës, për t'i vërtetuar se janë apo nuk janë këto shpenzime që janë paraqitur në raport. Sa i përket raportit, kryesisht të dy pikave për të cilat po diskutohet, Shpendi ka paraparë investime rekorde për vitin 2018, në ndërkohë që nuk ka qenë në gjendje t'i shpenzojë as mjetet e bartura nga viti 2017.

Për vitin 2018, shpenzimet kapitale kanë qenë në nivel rekord, prej 38.5 milionë euro, por në fakt shuma reale ka qenë vetëm 21.5, pastaj kjo shumë gati është dyfishuar falë mospunës së vitit 2017. Cila është logjika ekonomike e një kryetari të komunës, i cili nuk arrin të shpenzojë as 40% të buxhetit për shpenzime kapitale!

Te tabela "Të hyrat e Komunës së Prishtinës në vitin 2018", thuhet se ka rritje prej 16% në raport me vitin 2017, por në fakt fshihet fakti që gati e gjithë rritja nuk është aspak rritje, por vetëm si rezultat i vendimit që pagesat për mbeturina të bëhen në konton e Komunës.

Duket se tek shpenzimet buxhetore ka vetëm një fushë ku Komuna shkëlqen, e ajo është shpenzimet për mallra dhe shërbime, ku Komuna ka rritur buxhetin në raport me buxhetin paraprakë për rrafsh 53.5%. Çka i duhen kaq para Komunës për mallra dhe shërbime, kur asnjë projekt nuk po realizohet?!

Komuna ka shpenzuar pak mjete për projektet të cilat i ka premtuar kryetari, andaj janë shumë projekte të fushave të ndryshme që janë shpenzuar mjete me një përqindje shumë të vogël, por ka edhe projekte për të cilat nuk janë shpenzuar fare mjete.

Egzon Azemi tha se krahasuar me vitet 2016 dhe 2017, në paga dhe mëditje shpenzoheshin diku rreth 27, 28 milionë euro, ndërsa tash për një vit të vetëm në këtë kategori shpenzimet janë rritur në rreth 3.000.000 euro. Në kategorinë "Mallra dhe shërbime" gjatë vitit 2018, shpenzimet janë rritur në mbi 6.000.000 euro, pra shpenzimet që rriten vazhdimisht nga kjo qeverisje, ndryshe mund t'i quajmë shpenzime të luksit, ndërsa ngecën shfrytëzimi i buxhetit në kategoritë prej të cilave direkt përfitojnë qytetarët. Pra, ka mungesë tek investimet kapitale, e gjithashtu edhe te subvencionet.

Për 12 muaj, Komuna ka shpenzuar 30.000 euro për dreka dhe darka zyrtare, ndërsa të aprovuara ishin vetëm 25.000 euro. Për telefona mobil ka shpenzuar 83.000 euro, mbi 8.000 euro më shumë sesa kishte planifikuar, për karburante për vetura ka shpenzuar 163.000 euro, apo 3.000 euro më shumë se planifikimi, kurse tek qiraja për vetura është skandaloze për

180.990 euro, ku në vlerë totale tek qiraja për vetura janë shpenzuar nga buxheti i Komunës 235.990 euro, apo 300% më shumë.

Kryetari i Komunës lidhur me çështjen e arkëtimit, vlerëson se realizimi i të hyrave vetjake në vitin 2018, është realizim i mirë dhe tejkalon realizimin paraprak të vitit 2017, dhe thotë se pritet që në vitin 2019 do të ketë tejkalim të planifikimit të të hyrave vetjake.

Në qeverisjen e LVV-së në vitin 2017, kanë qenë të ndara 562.000 euro për bujqësi, ndërsa sot nga këta që veten e quajnë socialdemokratë, e që as fare nuk përngjajnë me një koncept të tillë, ndahen për Drejtorinë e Bujqësisë vetëm 207.000 euro për vitin 2018. Për këtë shifrat flasin më mirë se fjalët. Shpendi ka paraparë investime rekord për vitin 2018, në ndërkohë nuk ka qenë në gjendje t'i shpenzojë as mjetet e bartura të vitit 2017. Të gjitha këto argumente janë dëshmi e tjetërsimit të Komunës, ajo po i përngjan një institucioni për pazare të 2-3 partive dhe të 2-3 kompanive të ndërtimit, me qëllim që të përfitojnë pushtetarët.

Adrian Berisha rreth këtij raportit ngriti një çështje, duke thënë se te Drejtoria e Kulturës thuhet "Dekorimi i qytetit për festa është 0.00%", kurse realisht projekti është kryer. Kërkoj që dikush nga ekzekutivi të dalë me një sqarim dhe të tregohen pak më real kundrejt asaj që figuron këtu në këtë raport.

Vlora Dumoshi falënderoi drejtoreshën e Financave, znj. Valbona, e cila gjithmonë është e gatshme me qasjen e saj edhe i pranon të gjitha vërejtjet, në rast se ka, ose sugjerimet tona. Ajo ka bërë një punë mjaft të mundimshme me tabela, por kisha dashur që ky raport financiar me qenë më pozitiv. Ky raport flet shumë për mos punën dhe menaxhimin e kësaj qeverisjeje. Vetë fakti se të gjithë asamblistët e partive të ndryshme e ngritën zërin për raportin, për drejtorinë në veçanti, me të gjithë pajtohem, por kjo shuma e bartjes për mua gjithmonë ka qenë shumë shqetësuese, kur janë në pyetje 25.000.000 euro, dhe kjo më së shumti i prek qytetarët e komunës së Prishtinës, pra pa infrastrukturë, pa shkolla, pa Galeri të artit, pa salla, pa fusha sportive etj.

Këto bartje të mjeteve flasin më së miri për menaxhimin e dobët të Komunës së Prishtinës, mbase këta drejtorë të cilët i kemi këtu përpara, edhe këta ndjehen sot keq, se në përqindje të realizimit të projekteve ose programeve të tyre janë shumë të pakta. Uroj që këto projekte të realizohen, sepse janë shumë të nevojshme, pastaj janë para të cilat i takojnë Komunës së Prishtinës për qytetarët e Prishtinës, për një jetë më të mirë, qoftë në pjesën shkollore, kulturore, në mirëqenien sociale etj.

Leutrim Retkoceri tha se sa i përket Raportit financiar buxhetor të Komunës për vitin 2018, do fokusohem te shpenzimet kapitale. Ashtu si në raportin e kaluar, edhe në këtë raport shpenzimet kapitale lënë shumë për të dëshiruar, çdoherë e më shumë po e shohim që është një ulje e shpenzimeve kapitale. Ky raport e nxjerrë edhe njëherë se në këtë, vit krahasuar me vitin e kaluar, ka rreth 1.000.000 euro më pak shpenzime në kategorinë e shpenzimeve kapitale. Kjo tregon edhe një herë se nuk është duke u punuar në projekte madhore që i duhen Komunës së Prishtinës, në këtë buxhet shihet se 25.000.000 euro janë të pashpenzuara. Do të ishte mirë që këto mjete të shpenzohen në projekte të tjera, siç është nisja e punëve për unazën e kryeqytetit, ndërtimin e më se 5000 parkingjeve, apo edhe 50 parqe për qytetarët e Prishtinës etj. Shpresoj dhe besoj që qeverisja komunale do të aftësohet në realizimin e këtyre mjeteve.

Vala Peshku tha se sa i përket votimit të raportit financiar, në parim nuk kemi asgjë kundër kësaj, por nëse është praktikë e gabuar, nuk duhet thënë që duhet rregulluar, sepse nuk e kuptoj votimin e raportit financiar. Shpjegomani pse votohen raportet financiare, kjo është informatë, është numër, për çka votohet?! Ma shpjegoni arsyen pse duhet me u votuar raportet financiare!

Kryesuesi tha se edhe unë e kam kërkuar këtë përgjigje vazhdimisht, jo vetëm në Kuvend të Prishtinës, por edhe në Kuvend të Kosovës, se a votohet për gjëra të tilla, për raporte. E rëndësishme dhe përmbajtëse është me e votuar buxhetin, ku kanë me u planifikuar projekte të ndryshme, por raporti nuk është që ndryshohet diçka, qoftë të votohet pozitivisht apo negativisht.

Agim Gashi tha se kjo nuk është informatë, por është raport, dhe është dokument obligues ligjor. Ligji për financat lokale dhe Ligji për pushtetin lokal, e obligojnë Kryetarin e Komunës që të raportojë në periudha të ndryshme të vitit dhe në fund të vitit. Raporti vjetor votohet në Kuvend, është obligim ligjor, prandaj duhet të votohet.

Kryesuesi i hodhi në votim raportet financiare buxhetore.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, 17 vota kundër dhe 3 abstenime, u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2018 (TM4).

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, 17 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2018.

Pika e katërt

Propozimvendimi për miratimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2019.

Agim Gashi tha se do të ishte mirë që në njërin nga mbledhjet e radhës, p.sh. në muajin qershor, të parashihet aktiviteti përmes promovimit të të drejtave të fëmijëve, me temën “Promovimi i të drejtave të fëmijëve sipas Planit të veprimit”.

Vala Peshku theksoi se për muajin korrik është paraparë edhe “Informata mbi Planin e mobilitetit”, ndërsa ne sot veç e kemi në rend të ditës. Këtë informatë mund ta lëmë edhe për muajin korrik, por nuk e di se sa do të jetë real diskutimi sot.

Osman Bllaca tha se Plani i mobilitetit që është sot për diskutim, ka ardhur në Kuvend me propozimin e kryesuesit dhe kryetarit, por kjo informatë të mbetet edhe për muajin korrik.

Sami Boroci u shpreh se nëse ky plani i mobilitetit veç është gati i finalizuar, ndoshta muaji korrik është pak i largët për të diskutuar edhe një herë në Kuvend.

Ai kërkoi nga ekzekutivi që në seancën e ardhshme atë materialin që e kanë publikuar dje në ueb-faqe të Komunës, me e sjellë në Kuvend dhe me e trajtuar më seriozisht.

Egzon Azemi propozoi që në muajin nëntor me qenë e përfshirë edhe një seancë solemne për nder të datës historike të 28 Nëntorit.

Shefqet Osmani tha se aty ku thuhet, te muaji maj, “vizitë studimore në Turqi”, kërkoj që kjo të shtyhet për muajin e radhës, pra në qershor, për shkak se në muajin maj është

Ramazani. Sa i përket materialit në kopje fizike, kërkoj që materiali të merret në formën e shkruar mundësisht të paktën pesë ditë para seancës.

Kryesuesi tha se materialet në kopje fizike po vijnë me vonesë, por është çështje e teknikës, d.m.th. ka ngarkesë të madhe edhe nuk po mund të fotokopjohen, sepse kemi të bëjmë me material voluminoz.

Agim Gashi propozoi që në muajin shkurt të jetë pika “Informatë për mbjelljet pranverore”, pra dhe është mirë që drejtoria përkatëse të na ofrojë një informatë sezonale në prag të përgatitjeve për mbjellje. Njëherësh ai kërkoi që për muajin dhjetor të parashihet edhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2020.

Vlora Dumoshi theksoi se do të ishte mirë të parashihen edhe panairët, duke filluar nga pranvera, nga 8 Marsi, e pastaj sidomos kultivimi i luleve në komunën e Prishtinës, sepse ka shumë biznese të vogla që menaxhohen nga gratë. Muaji tetor është muaji i rinisë, andaj është mirë që të ketë bashkëpunim me këto organizata rinore dhe muajin rinor me e përfshirë në kalendarin e Komunës.

Shefki Gashi shprehu mendimin se do të duhej të ndahej një buxhet i caktuar për nevojat e Kuvendit të Komunës, çoftë për trajnime, çoftë për ndonjë bashkëpunim me komunat e tjera, çoftë me vendet tjera, çoftë me ndonjë udhëtim jashtë vendit ose brenda vendit. Gjithashtu ceku se do të ishte mirë që në këtë plan të punës së Kuvendit, të parashihet ndonjë projekt apo ndonjë plan, që ne anëtarët e Kuvendit të takohemi ndonjëherë edhe jashtë këtyre seancave, kështu që edhe ne të takime mes veti, të njihemi kush jemi, çka jemi.

Adrian Berisha propozoi që në njërin nga mbledhjet e radhës, të futet në rend dite për diskutim Rregullorja për subvencione, pasi që kjo rregullore ka disa gabime dhe ato të përmirësohen. Njëherësh ai pyeti se a ka mundësi që në seancën e muajit prill të jetë edhe Propozimrregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste. Ai bëri të ditur se e ka dorëzuar një kërkesë në drejtim të kryetarit, z. Shpend Ahmeti, përmes së cilës ka kërkuar që këtë njëzetvjetor të çlirimit të Prishtinës me e kremtuar me aktivitete të ndryshme kulturore, sportive, rinore, dhe propozoi që kjo të futet në Planin e punës së Kuvendit për muajin prill.

Kushtrim Sopa, propozoi që për seancën e muajit qershor ose korrik, të futet në rend dite “Gjendja e infrastrukturës sportive në qytet”, që zakonisht janë muajt e parapërgatitjeve për stinoret e reja të aktiviteteve sportive.

Sami Boroci, sa i përket Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, tha se kjo rregullore ka qenë edhe më herët, ku unë pata kërkuar me e hequr nga rendi i ditës, me i bërë disa grupe punuese edhe me e rishqyrtuar edhe një herë, veçanërisht disa pjesë të gastronomisë dhe disa sektorë të tjerë të ndërtimit. Ndërsa sa i përket propozimit të z. Shefki Gashi, mendoj se do të ishte mirë me e bërë një grup punues me përfaqësues të të gjithave grupeve dhe me dalë me një propozim konkret, që nëse ka hapësirë në Komunë, me u paraparë çoftë edhe vetëm një zyrë për asamblistë.

Fiknete Bejta u shpreh e pajtimit me diskutimin e parafolësit, që Propozimrregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste dhe veprimtarive të tjera në komunën e Prishtinës dhe Propozimrregullorja për leje të punës, të jenë për diskutim në Kuvend në seancën e muajit prill.

Rifat Deri ishte i pajtohem me propozimin që për muajin prill të caktohet një pikë e posaçme për caktimin e orarit të punës. Mirëpo në lidhshmëri me këtë shtoi në veçanti orarin e shkarkimit dhe ngarkimit të mallit që po bëhet në qytet, pasi që prej orës tetë apo nëntë në mëngjes, kur është komunikacioni më i dendur, kemi shumë kamioneta që shkarkojnë mallra afër shitoreve dhe kjo po pengon në zhvillimin e komunikacionit. Po ashtu, në kuadër të kësaj pike të merren parasysh edhe kamionët të cilët bartin beton, ku ata në shumicën e rasteve po derdhen pjesë të madhe të betonit, e cila pastaj me një kohë po shtresohet dhe dalëngadalë gjatë qarkullimit të automjeteve po bëhet pluhur. Pra, kisha pasur dëshirë të hapim një diskutim në lidhje edhe me këtë çështje.

Eman Rrahmani propozoi që në seancën e muajit shtator, si pika për diskutim të jenë edhe Harta zonale dhe Plani zhvillimor.

Leutrim Retkoceri propozoi që për seancën e muajit nëntor, në Planin e punës së Kuvendit, si pikë e rendit të ditës të parashihet një seancë për nder të 28 Nëntorit, Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë. Po ashtu kërkoi që në Planin e punës së Kuvendit për vitin e ardhshëm, të parashihet një seancë solemne për nder të 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës.

Ai njëherësh propozoi që Rregullorja për ushtrimin e veprimtarive "Auto-taksi", me kaluar nga muaji qershor në muajin mars.

Me propozimet e dhëna, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, me 36 vota për, u miratua Planit vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2019.

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë.

Dren Kukaj, në cilësinë e ish-drejtorit të Drejtorisë së Pronës, theksoi se kjo pikë ishte në rend dite edhe në mbledhjen e kaluar, por për shkak se ishin vetëm 23 vota për, e të tjerat ishin abstenime, kjo nuk kaloi, megjithatë kjo pikë nuk kishte kundërshtime për të mos kaluar. Sa i përket dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Policisë së Kosovës, kjo ka të bëjë me nevojat e ndërtimit të Stacionit nr. 4 të Policisë së Kosovës, ku më herët ai stacion ka qenë në Lakërishtë dhe për momentin ata janë duke e shfrytëzuar hapësirën e objektit të ish- hotelit "Viktoria".

Vjosa Hamiti - Krasniqi tha se me sa po shihet, në këto dokumente totali i sipërfaqes në parcelën kadastrale 289-23 është 63.239 m². A është ndarë apo a është parcelizuar kjo pjesë e tokës, apo duke e ditur se në Kadastër duhet të regjistrohen si parcela të ndara, pasi që është obligim ligjor?

Dren Kukaj theksoi se këto parcela është e pamundur që të ndahen dhe ne do ta marrim vetëm atë hapësirën prej 37.239 m², mirëpo ndarja është e pamundshme.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPK "Trafiku Urban", SHA, në Prishtinë.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Policisë së Kosovës.

Kryesuesi tha se arsyeshmërinë për dhënien e kësaj prone në shfrytëzim për Policinë e Kosovës, e paraqiti Dren Kukaj, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, u miratua Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Policisë së Kosovës.

Pika e shtatë

Propozimrregullorja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Lidhur me Propozimrregulloren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Premtime Preniqi, koordinatore e Njesisë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.

Agim Gashi tha se në këto dokumente vërejmë disa paqartësi, si p.sh. te neni 5, ku thuhet "Mekanizmat koordinuese për mbrojtjen e fëmijëve në nivel komunal", ose thuhet "Mekanizmi koordinues më tutje", po më tutje nuk janë dhënë sqarime se ç'është ai mekanizmi koordinues. Askund nuk është sqaruar sa anëtarë i ka mekanizmi koordinues, kush e përbënë mekanizmin koordinues, kush e formon mekanizmin koordinues dhe çka është ai mekanizmi koordinues. Meqenëse është Rregullore, Projektregullore, do duhej t'i jepte këto sqarime.

Po ashtu, do të duhej të jepeshin edhe sqarime se cila drejtori e ka sponsorizuar këtë dokument, çka ka dashur me arritur me këtë krijimin e mekanizmit koordinues, të cilit ia ka bartur barrën kryesore në krejt këtë aktivitet dhe mbi të cilin bie barra kryesore në zbatimin e kësaj rregulloreje.

Në përmbajtjen e kësaj rregulloreje janë paraparë disa aktivitete, si përfshirja e mësimin për të drejtat e fëmijëve dhe Konventës së të drejtave të fëmijëve në kurrikulën në bazë shkollore, dhe kjo rregullore po sillet sikurse askush deri më tani nuk është marr me të drejtat e fëmijëve në Kosovë!

Të gjitha përmbajtjet për të drejtat e fëmijëve çoftë ligjore, çoftë marrëveshjeve ndërkombëtare, çoftë legjislacionit brenda Kosovës, janë inkorporuar në programin shkollor, përkatësisht në kurrikulën shkollore në Kosovë, dhe nuk ka nevojë me dalë kjo tash sikur kjo Komunë, në bazë të kësaj rregulloreje do ta marrë një iniciativë që ato gjëra t'i integrojë në kurrikulë etj.

Leonora Shabani - Bajraktari tha se edhe ne e përkrahim këtë projektregullore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën tonë dhe në parim Planin e veprimit.

Aq shumë ka nevojë për mbrojtjen e promovimit e të drejtave të fëmijëve, sa që fëmijët tanë në këto momente nuk kanë ujë të pijshëm në shkolla, mungojnë pajisje higjienike në mjediset shkollore, d.m.th. gjërat më elementare. Ata nuk mbrohen nga dukuritë, si: shfrytëzimi, abuzimi, mungesa e hapësirave të gjelbëra dhe shumë gjëra të tjera. Pra, të

gjitha këto mungojnë, e që janë të drejta bazike dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen, zhvillimin, mirëqenien dhe shëndetin e tyre.

Gjithashtu fëmijëve me nevoja të veçanta, e sidomos ata që kanë probleme fizike, nuk e kanë të drejtën të vijojnë mësimin e tyre në lëndët e ndryshme, nuk mundën të vijojnë mësimin në kabinetet e ndryshme, d.m.th. ata privohen nga kjo e drejtë.

Vlora Dumoshi shprehu falënderim për angazhimin e zyrtares së Komunës së Prishtinës, dhe është e gatshme të bashkëpunuar edhe me organizatat e jashtme joqeveritare, ku edhe e listoi listën të cilët kanë punuar në këtë projektregullore, e që është kërkesë nga MSA-ja që komunat me e pasur këtë rregullore.

Edhe përkundër disa vërejtjeve që u dhanë për këtë rregullore, kjo rregullore është shumë domethënëse, që Komuna e Prishtinës në një të ardhme shumë të shpejt duhet ta marrë vendimin dhe ta miratojë.

Arbenita Murseli, lidhur me Planin e veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës, tha se do të ishte krejt në rregull nëse do të plotësoheshin të gjitha këto objektiva, si pjesëmarrja, duke i fuqizuar fëmijët si vendimmarrës, ta kenë mirëqenien sociale dhe shëndetin, t'u sigurohet arsimit, të parandalohen dukuritë negative, të mbrohen nga ato etj. Por, fatkeqësisht, të gjitha këto nuk u sigurohen fëmijëve, sidomos atyre me nevoja të veçanta, si me Sindrom Daun, Autizëm etj. Këta fëmijë duhet të trajtohen të barabartë si të gjithë fëmijët e tjerë. Në parim, si grup jemi për miratimin e Planit të veprimit, duke uruar dhe shpresuar se këtu do të përfshihen të gjithë fëmijët në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

Kryesuesi konstatoi se më 32 vota për, 2 kundër, u miratua Rregullorja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Pika e tetë

Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës 2019-2021.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, 1 kundër, u miratua Vendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës 2019-2021.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri (Rifat) Hoxhës dhe Besnik (Halit) Asllanit

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, 1 kundër dhe 4 abstenime, nuk u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri (Rifat) Hoxhës dhe Besnik (Halit) Asllanit.

Pika e dhjetë

Informatë për hartimin e Hartës Zonale të komunës së Prishtinës dhe Planit zhvillimor komunal të Prishtinës.

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se në mars të vitit të kaluar e kemi miratuar vendimin për hartimin e Planit zhvillimor komunal dhe të Hartës zonale, dhe si drejtori jemi duke punuar në hartimin e këtyre dy dokumenteve shumë me rëndësi për Komunën e Prishtinës, në bashkëpunim edhe me akterë jashtë Komunës. Sigurisht që ka edhe sfida, ka edhe probleme gjatë këtij rrugëtimi, por sot do ta bëjmë një prezantim më në detale të Planit zhvillimor komunal dhe të Hartës zonale.

Arta Osmani, përfaqësuese e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në detale bëri prezantimin e kësaj pike, duke i njoftuar të pranishmit rreth punës e cila është bërë në përgatitjen e hartimit të këtij dokumenti.

Halim Halimi tha se ka qenë mirë që kjo informatë të na ishte sjellë para 5 vjetëve dhe është një e mirë që të fillohet hartimi i HZK-së, është një e mirë që janë bërë disa hapa në drejtim të hartimit, mirëpo a mjaftojnë këto hapa, nuk mjaftojnë. Me sa e vërejta, jemi bukur larg hartimit të HZK-së deri në muajin shtator.

Egzon Azemi theksoi se te tabela e planifikimit, ku edhe u përmend p.sh. se incizimet gjeodezike, tenderi për to ka filluar në janar, te ajo tabelë ku kanë qenë të renditura disa që kanë startuar dhe disa që kanë përfunduar, a mund ta dimë se sa prej tyre kanë përfunduar dhe sa prej tyre kanë startuar punën në atë drejtim.

Eman Rrahmani pyeti se kur është afati që parashihet të përfundoj PZHK-ja dhe HZK-ja. Po ashtu kërkoi që të përshpejtohet ky proces, për shkak se është jetik për Prishtinën, kështu që mos të pengohemi me procese të tjera të cilat fillojnë paralelisht me këto dy procese. Kjo besoj se do të ishte një zgjidhje më e mirë, andaj mos të na sjellin plane të tjera të hollësishme rregulluese pa u përfunduar këto dy dokumente strategjike për Prishtinën.

Sami Boroci, kërkoi që ky material- prezantim t'u dërgohet edhe në e-mail adresë të gjithë këshilltarëve.

Agim Gashi kërkoi të dijë se sa për qind të punëve janë kryer dhe sa kanë mbetur pa u kryer. **Vlora Dumoshi** theksoi se me të dhënat të cilat na u prezantuan, shihet se është tek fillimi, por ne urojmë që pas sa muajve ta kemi edhe një informatë tjetër, ku do të shohim se si po ecën procesi.

Lidhur me vërejtët dhe pyetjet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Genc Bashota, drejtor, dhe Arta Osmani e Burbuqe Hydaverdi përfaqësuese të drejtorisë.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa e kolektorit.

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit lidhur me këtë propozimvendim.

Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se kjo rrugë e ka një rëndësi të madhe, për arsye se aty kalon edhe kolektori,

që nënkupton se tash për tash gjendja është shumë e keqe, ka kundërmime, rrezik për ndonjë epidemi, andaj paraqet një nevojë imediate për reagim.

Eman Rrahmani, tha se dihet që gjendja në lagjen "Kalabria" është jashtëzakonisht e rëndë dhe shumë qytetarë kanë shumë ankesa rreth kësaj çështje, mirëpo ju në raportin dhe në inicimin e juaj në këto plane rregulluese, arsyen kryesore e keni cekë se është vazhdimi i rrugës "B", e kam fjalën për "Matin". Sipas këtij Plani, planifikohet t'u jepet koeficiente pronarëve privatë për ta lejuar trasenë e rrugës së planifikuar dhe njëherësh për t'u mundësuar ndërtimin e rrugës, për të cilën rrugë janë zotuar mjetet në buxhetin e vitit 2019. **Egzon Azemi** theksoi se ne vazhdimisht kemi kritikuar për qasjen e drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit, që po e vazhdon edhe tash, pra këto dokumente, këto plane të hollësishme rregulluese, do të inkorporohen në Hartën zonale. Për ne ky është problem për t'u bërë një plan rregullues, pra do të votohet Harta zonale ose një dëm këtu po shkaktohet! Cila është arsyeja pse është zgjedhur kjo formë, pikërisht se e dini se nuk ka me përfunduar as në shtator Harta zonale.

Sami Boroci u shpreh se problemet infrastrukturore në Prishtinë janë goxha të mëdha, kolektori, vazhdimi i rrugës "B", ndërlidhja me rrugë "A" etj., Kjo duhet të trajtohet dhe me gjetur modalitet patjetër dhe me i kaluar, me hapur rrugë që këto me ecur përpara. Po kritikojmë për investimet kapitale pse nuk janë realizuar, mirëpo në fakt po i bie që ne këto investime kapitale përmes një forme po i bllokojmë.

Mimoza Sylejmani tha se më në fund erdhi një zgjidhje e problemit për lagjen "Kalabria" dhe "Mati", sepse kemi pasur shumë ankesa nga qytetarët e kësaj pjese të qytetit. Harta zonale nuk e pengon aspak realizimin e këtij projekti. Pra, vetëm bëhet një inkorporim, ku ai projekt i bashkëngjitet kësaj pjesës tjetër.

Halim Halimi theksoi se të gjithë e dimë se sa janë të nevojshme këto projekte edhe për lagjen "Kalabria", edhe për rrugën e lagjes "Mati", dhe duhet filluar menjëherë se janë me rëndësi, por nuk janë kryer punët paraprake. Qe 5, 6 vjet është pritur që të bëhet Harta zonale dhe kjo nuk është bërë!

Nol Nushi, tha se për vendimin e këtij Kuvendi konfirmimin e ligjshmërisë nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, e cila nuk na lejon të bimë ndesh me ligjin. Ne kemi marrë vendim për dy plane të tilla rregulluese, nuk ka vendime negativ nga Ministria, pra ne këtu e bëjmë një vendim, e dërgojmë në Ministri, Ministria thotë po ose jo, nuk është opinionin ynë subjektiv.

Leutrim Retkoceri theksoi se sa i përket këtyre dy pikave, ne i diskutuam dhe i analizuam, përjashtimisht qarkores që e presim prej Ministrisë, edhe ky koeficienti që do të jetë një çështje pak hipotetike se sa do të vendoset, mendoj që janë dy tema mjaft me rëndësi për lagjen "Mati 1" dhe lagjen "Kalabria". Shpresoj edhe besoj që do duhej të kalojë, t'u japim një zgjidhje atyre qytetarëve, pastaj ta marrim edhe një përgjigje nga Ministria, që nëse është nevoja të plotësohet diçka lidhur me të.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, 3 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën "Mati 1", vazhdimi i rrugës "B" (Bahri Fazliu), pjesa e kolektorit.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit.

Egzon Azemi ngriti një shqetësim lidhur me këtë propozimvendim, duke thënë se do të ishte mirë që të pritët përgjigje nga Ministria, pasi që nëse votohet ky propozimvendim, do të përdoret si precedent për shumë zona të tjera, kompani të ndryshme të ndërtimit të afërta me Komunën e Prishtinës, nëpër lokacionet të ndryshme të Prishtinës. Sipas dëshmimeve që po jepen nga qytetarët, po tregojnë se kompanitë e afërta me Komunën dhe me pushtetarët e kësaj komune, po i takojnë qytetarët dhe po iu premtojnë se me planet rregulluese të hollësishme do të përfitojnë nga koeficientët e ndërtimit dhe këto po ndodhin shumë afër këtyre rrugëve ku sot jemi duke votuar.

Nol Nushi theksoi se nëse ne sot i votojmë këto propozimevendime, konfirmohet ligjshmëria në Ministri se janë të ligjshme apo jo, dhe nëse këto vendime janë të ligjshme procedohen më tej.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, 2 kundër dhe 6 abstenime, u miratua Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Kalabria", pjesa e kolektorit.

Pika e trembëdhjetë

Informatë për procesin e Planit të mobilitetit.

Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, tha se Plani i mobilitetit të qëndrueshëm urban është një dokumente strategjik, në të cilin është punuar në një periudhë brenda dy viteve, Komuna në bashkëpunim me kompaninë e mirënjohur M.M. Donald, dhe si i tillë ky plan e përcakton lëvizshmërinë e autobusëve, makinave, këmbësorëve dhe biçikletave. Plani i mobilitetit nuk është vetëm i Sektorit të planifikimit, por i të gjitha drejtorive së bashku që janë të kyçura në hartimin e tij. Si i tillë, ky dokument do të inkorporohet në Hartën zonale, për arsye se është dokumente që hyn në planifikimin afatgjatë.

Burbuqe Hydaverdi, përfaqësuese e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në pika të shkurtra bëri prezantimin e këtij plani.

Sami Boroci tha se kur do të fillojë zbatimi i këtij plani, pasi që veç edhe një pjesë e buxhetit që është ndarë ka një vlerë për shtigjet e çiklistëve, pra gjithqysh duhet kjo me filluar sa më parë që është e mundur.

Leutrim Retkoceri tha se sipas diskutimeve që u bënë për Planin e mobilitetit, shihet se në këtë plan për parkingjet pak është diskutua, andaj jam kureshtar të dijë se si është menduar të zgjidhet problematika dhe nevoja e parkingjeve në Prishtinë.

Nga ajo që u prezantua, shihet se u vënë në pah rëndësia që do t'u jepet këmbësorëve dhe më pak veturave. Do të jem shumë kureshtar të dijë se kur do të përfundojë Plani i mobilitetit, pra do të ishte mirë që të jetë një datë e caktuar.

Genc Bashota, drejtor, tha se ky dokumente strategjik i cili është përfunduar, është kompletuar, dhe tash besoj se së shpejti kryetari e hedh edhe në diskutim në Kuvend, dhe si i tillë ky duhet të zbatohet.

Pika e katërbëdhjetë
Pyetje dhe përgjigje.

Naime Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit dhe Kryetarin e Komunës:

- Në këtë vit a është në projekt për realizim ndërtimi i rrugëve kryesore në fshatin Besi, por edhe rrugët përcjellëse që janë anësore? Sipas kërkesës së këtyre banorëve, nga Drejtoria kërkohet që këto projekte të shkojnë në tender në paketë, që mos të bëhet përçarje mes tyre.
- Banorët e fshatit Besi, po ashtu edhe të lagjes së Prugovcit, kërkojnë ndërtimin e një shkollë të re në Besi, pasi që ajo ekzistuesja nuk i plotëson kriteret e tanishme. Banorët e fshatit Tenezhdoll kërkojnë që të bëhet ndriçimi i rrugëve ashtu si në fshatrat tjera, asfaltimi i rrugëve asnësore, si dhe të emërtohen rrugët dhe të vendosen tabela në ato rrugë.
- Banorët e lagjes “Kalabria” i kanë shprehur shqetësimet lidhur me rrugët, trotuaret dhe ndriçimin të shkollës “7 Marsi”. Një rrezik permanent për nxënës të kësaj shkollë janë edhe qentë endacakë, pasi që mungon rrethoja e shkollës. Po ashtu, dështimi i kolektorit paraqet shqetësim për këta banorë. Gjithashtu disa lokale të bizneseve të ndryshme të platoja të Posta e re dhe të Kurrizi, për shkak të hyrjes së ujit në lokale, pronarët janë detyruar t’i mbyllin ato. Kërkoj të dijet se a ka gjasa të dëmshpërblehen ata pronarë.
- Një banor i lagjes “Mati 1” pyet se sa banesa kolektive i ka legalizuar Komuna që një mandat e gjysmë?
- Lejet e banesave kolektive që lëshohet për çdo ditë, a janë në përputhshmëri me normat e ndërtimit që i përcaktojnë ligjet e Kosovës, nëse mendon se janë të lëshuara në bazë të kriterëve, a është e mundur që në shumicën e rrugëve ku i keni lëshua këto leje të ndërtimit, nuk keni bërë infrastrukturë që përfshin instalimin e kanalizimit ujësjellësit, ndriçimit, sepse pikërisht ky dështim i juaji është shkaku kryesor që për çdo ditë kemi bllokim të kanalizimeve, të cilat rrezikojnë shëndetin e qytetarëve? Ajo që është më brengosëse, është fakti që statikën e këtyre objekteve që Komuna i lëshon lejet për to e që nënshkruajnë inxhinieret tuaj, janë bombë që shumë lehtë mund të aktivizohet për banorët që jetojnë në këto banesa. Si është e mundur që nuk i përmbaheni një kriteri që parasheh ligji për normat e ndërtimit, që mos me iu lejuar banorëve të hyjnë në ato banesa pa e lëshu certifikatën e banimit apo pa i pranuar teknikisht?

Sugjeroj kryetarin që nëse nuk është i zënë me platformën e dialogut, të dalë në lagjen “Mati 1” dhe të shoh se si disa kompani që janë duke i kryer punimet e vrazhda dhe janë duke punuar në katin e 9-të dhe të 10-të pa mjetet mbrojtëse për punëtorë, d.m.th. pa skele për sigurinë e punëtorëve.

Faqe 18 nga 20

Halim Halimi, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Banorët e Malësisë së Gollakut kërkojnë një linjë të transportit publik Prishtinë - Prapashticë - Ballaban - Hajkobillë, ngase transporti publik atje është duke u bërë me disa mjete të vjetruara.

Mirsad Vitia, për drejtorin e Drejtorisë së Parqeve dhe z. Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës:

- Qytetarët e Hajvalisë kërkojnë që së paku në rrugën kryesore "Dëshmorët e Gollakut" (në pjesën e trotuarit, në hapësirat e shkollës, të xhamisë e kudo ku ka mundësi) të mbillen fidanë dekorativ dhe gjethembajtës (p.sh. pisha), për ta parandaluar një keqësim të mëtejshëm të situatës ambientale. Qytetarët e Hajvalisë, sidomos gjatë verës, frekuentojnë vazhdimisht këtë rrugë, në veçanti pjesën përballë Inspektoratit Policor të Kosovës, dhe një projekt i tillë më shumë gjasë do të ndikonte direkt në përmirësimin e jetës në këtë pjesë të Prishtinës.

Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave, dhe drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit:

1. Nevojë emergjente për ndriçim publik rrugët: "7 Shtatori", "Lutfi Vitia" dhe "Dil Mramori";
2. Parkingut në rrugën "Toni Bler", pranë shkollës "Mehmet Gjevori", në lagjen "Arbëria", ngase po kanosen nxënësit dhe banorët e lagjes;
3. Rregullimi i infrastrukturës në lagjen "Kalabria";
4. Pse po bllokohet ndërtimi i Xhamisë qendrore në Prishtinë, a është lëshuar leja e ndërtimit nga Komuna e Prishtinës?;
5. Rregullimi i rrugës në lagjen "Hani i Dilit", rruga "Evlia Çelebi", e cila është e hapur për punime prej më shumë se 5-6 muaj, duke i lënë pusetat e larta, pa shtresë të zhavorrit dhe asfaltit, ku po dëmtohen shumë vetura dhe është përhapur baltë e madhe në këtë rrugë;
6. Rregullimi i rrugës "Llapi" në mëhallën e Luan Çelajt, e cila është hapur për punime prej më shumë se 5 muaj, në këtë rrugë janë shtruar ca gurë, prej të cilëve nuk mund të kalojnë veturat;
7. Rruga "Dëshmorët e Marecit" është e vetmja rrugë pa linjë të transportit publik në këtë lagje, andaj a do të ndërmerret diçka për këtë shqetësim? Në këtë rrugë nuk gjendet madje as një shportë e vetme e mbeturinave;
8. Parku "Toukbahçe", pjesa nga lagja "Velania", e cila është e mbushur me pemë dhe me pisha, nuk mirëmbahet pothuajse kurrë, e cila pjesë tani është mbushur me ferra dhe mbeturina. Në këtë pjesë nuk ekziston asnjë ulëse e vetme ose pushimore për qytetarët e kësaj lagje dhe vizitorët eventual;
9. Rregullimi i infrastrukturës tek lagja "Përroi i Njelmët" - rrugë, sinjalizime dhe trotuare;
10. Rregullimi i infrastrukturës në lagjen "Tophane";
11. Mirëmbajtja dhe renovimi i Parkut të lagjes "Arbëria".

Arbenita Murseli, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:

- Para disa javësh kam shtrua kërkesën për shtrirjen e rrjetit të ndriçimit në rrugën "Mbreti Bardhyl", afër lagjes së ashtuquajtur "Xhamia e Llapit", fjala është për zonën ku shtrihen qindra biznese për përpunimin e drurit. Kërkesë e shtruar nga këta banorë është se rrjeti i ndriçimit është i shtrirë vetëm në një pjesë të lagjes, pjesë-pjesë ndriçimi nuk është i rregulluar. Sipas banorëve dhe pronarëve të bizneseve, zyrtarët e Komunës kanë thënë se janë disa probleme teknike në disa llamba.
- Kërkesë tjetër është prej banorëve të Bardhoshit dhe të pjesës Bërnice e Poshtme, rruga "Stefan Mokranjac", kërkojnë zgjatjen e vijës, linjës nr. 3, së paku për dy stacione shtesë, deri te rruga "Kreshnikët" dhe "Stefan Mokranjac" vendi i ashtuquajtur Te Koshat.

Kumrije Shabani, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:

- Këshilli drejtues i prindërve të shkollën fillore "Nazim Gafurri", ka një shqetësim rreth sigurisë së nxënësve në oborrin e shkollës, pasi që oborri i kësaj shkolle shfrytëzohet edhe për hyrjen e nxënësve në shkollë edhe për automjetet dhe aty është e destinuar një hapësirë për parking, kryesisht për personelin e shkollës. Pronarët e lokaleve të bizneseve të ndryshme që gjinden afër kësaj shkolle, automjetet e tyre i parkojnë në oborrin e shkollës, si kamion me dru, me perime dhe shumë automjete dhe sende të tjera, d.m.th. oborri i shkollës po shfrytëzohet si treg. Në anën e pasme të shkollës është paraparë që të bëhet një parking, dhe të jetë i dedikuar vetëm për nevojat e shkollës. Pra zgjidhja e këtij problemi të kamotshëm do t'u siguronte nxënësve lëvizjen e lirë në oborrin e shkollës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta

